



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 428/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Murrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik, Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 11.12.2010, nga subjekti politik KDTP, me të cilën pretendohet se më datë 11.12.2010, në rrugën “Agim Ramadani” në Prishtinë, subjekti politik LVV, ka mbuluar posterat e subjektit politik KDTP, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi si dëshmi. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LVV, më datë 12.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 13.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik LVV, sipas afatit të caktuar, në të cilën theksohet se shkelja është bërë më datë 11.12.2010, ndërsa është nënshkruar nga parashtruesi i ankesës më datë 10.12.2010, që është në kundërshtim me provat e ofruara. Me propozim që ankesa e subjektit politik të refuzohet si e pabazuar.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (d) parasheh:

(d) vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara dhe kontradiktore me atë që është ofruar si dëshmi dhe atë që është nënshkruar nga parashtruesi i ankesës, sepse nga shkresat e lëndës rrjedh se ankesa është nënshkruar para se të ndodhë shkelja e supozuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 428/2010 më datën 13.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

